



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2022
Nr.ref.:RK 1937/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI168/21

Parashtrues

Petrit Dushi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 158/2021, të 2 korrikut 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Petrit Dushi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 158/2021], të 2 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizer, Çnjerezor ose Poshtëruar], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 23 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës si dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 29 mars 2011, parashtruesi i kërkesës për shkak të një deklarate të lajmëruar të kanosjes, ishte ndaluar përkohësisht nga Policia e Kosovës dhe më pas ishte dërguar në Stacionin Policor "Qendra" në Prishtinë, për të dhënë një deklaratë.
10. Më 23 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi për kompensim dëmi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke kërkuar kompensim në vlerë prej 53,500.00 euro, duke pretenduar se në mënyrë të paligjshme është privuar nga liria nga ana e policit Sh. D.

11. Më 24 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 1936/12] refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetim të Aktgjykimit, Gjykata Themelore shton se edhe përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës mund të ketë vlerësuar se ndalimi ka qenë i vrazhdë dhe i panevojshëm, bazuar në paragrafin 1, të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë e Kosovës, në rrethanat e rastit konkret konstatohet se zyrtarët policorë duke u bazuar në autorizimet e tyre ligjore kanë vlerësuar se ndalimi dhe dërgimi në Stacionin policor ka qenë i nevojshëm për të marrë deklaratën e parashtruesit të kërkesës.
12. Më tutje, në arsyetim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe gjatë adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, theksohet se: *“Sado që për paditësin si qytetarë i denjë i Republikës së Kosovës, ndalimi, dërgimi në Stacion policor dhe marrja e deklaratës për rastin, janë konsideruar si denigruese dhe të panevojshme, megjithatë në rastin konkret dhe raste të ngjajshme policia duhet vepruar në pajtim me ligjin dhe procedurat”*.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
14. Më 7 korrik 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4005/18] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës si dhe vërtetoi në plotni Aktgjykimin [C. nr. 1936/12] e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj e konsideroi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se drejtë është zbatuar e drejta materiale dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë.
15. Më 31 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën për revizion pretendoi se dy instancat më të ulëta nuk kanë adresuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë.
16. Më 2 korrik 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 158/2021] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës. Më tutje, në arsyetim të Aktgjykimit të lartpërmendur theksohet se nuk është krijuar baza ligjore për kompensim, sepse në rastin konkret zyrtari policor nuk ka tejkalluar autorizimet dhe as nuk ka përdorur forcë joproporcionale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar] dhe nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.

18. Parashtruesi i kërkesës lidhur me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës, fillimisht pretendon se: “Nga ndërhyrja brutale e ish-zyrtarit shtetëror, i është dhunuar një herë e përgjithmonë dinjiteti si qenie njerëzore dhe atë në vend publik, ku, përmes trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues të zyrtarit shtetëror i është shkelur edhe e drejta tjetër e garantuar me aktin më të lartë juridik të vendit: Ndalimi i torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues, të drejta këto elementare njerëzore të garantuara edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i shkaktuar edhe lëndime trupore”.
19. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton se: “Si gjykata instanciale e shkallës së parë edhe kjo Gjykatë [Gjykata e Apelit], duke shpërfillur pjesën e paditësit që bazohet në cenimin e të drejtave të tij kushtetuese, pa u trajtuar fare dhe pa i dhënë adresimin e duhur në fakt i ka mohuar paditësit zgjidhjen efektive para një organi kombëtar”.
20. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij thekson se edhe përkundër faktit se me asnjë provë nuk dëshmohet se parashtruesi ka kryer veprën penale për të cilën është ndaluar, ky fakt nuk përmendet fare në aktgjykimet e instancave gjyqësore. Në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet se vendimet e tri instancave gjyqësore nuk janë të arsyetuara, për faktin se parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta ka ngritur çështjen e shkeljes së të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë, pretendime këto të cilat sipas tij nuk janë arsyetuar.
21. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve ka përmendur edhe disa raste të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) (*Hansen kundër Norvegjisë*, Aktgjykim i 2 tetorit 2014; *Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 29 marsit 2010; *Ladent kundër Polonisë*, Aktgjykim i 18 qershorit 2008, *Creanga kundër Romanisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2012).
22. Parashtruesi i kërkesës në fund kërkon nga Gjykata, si në vijim: i) të shpallë kërkesën të pranueshme; ii) të konstatojë shkelje të nenit 23, 27 dhe paragrafëve 1 dhe 4 të nenit 29 të Kushtetutës; si dhe të shpallë të pavlefshme aktgjykimet e tri instancave gjyqësore.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 27

[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues]

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 29
[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e njëvepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

(3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

(4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;

(5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

[...]

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

[...]

LIGJI Nr. 04/L-076 PËR POLICINË

Neni 11

Autorizimet policore

1. Gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrorë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të jap dhe të zbatojë urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t'i arritur objektivat ligjore të policisë.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

26. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 158/2021] e 2 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që ka shteruar mjetet juridike.

27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

28. Gjykata i referohet edhe rregullit 39 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

29. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin e Gjykatës: KI04/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih, gjithashtu, rastin KI175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021.

31. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
32. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me faktin se më 29 mars 2011, parashtruesi i kërkesës për shkak të një deklarate të lajmëruar të kanosjes, ishte ndaluar përkohësisht nga Policia e Kosovës dhe më pas ishte dërguar në Stacionin Policor “ Qendra” në Prishtinë, për të dhënë një deklaratë. Më pas parashtruesi i kërkesës, kishte parashtruar padi për kompensim dëmi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke kërkuar kompensim material me pretendimin se në mënyrë të paligjshme është privuar nga liria nga ana e policit Sh. D. Gjykata Themelore kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se zyrtarët policorë duke u bazuar në autorizimet e tyre ligjore kanë vlerësuar se ndalimi dhe dërgimi në Stacionin policor ka qenë i nevojshëm për të marrë deklaratën e parashtruesit të kërkesës. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, këto të fundit refuzuan ankesën dhe e vërtetuan aktgjykimin e instancës së parë.
33. Gjykata rikujton se këto konstatime, parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar] dhe nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit, i cili para Gjykatës shton se: *“Nga ndërhyrja brutale e ish-zyrtarit shtetëror, i është dhunuar një herë e përgjithmonë dinjiteti si qenie njerëzore dhe atë në vend publik, ku, përmes trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruar të zyrtarit shtetëror i është shkelur edhe e drejta tjetër e garantuar me aktin më të lartë juridik të vendit: Ndalimi i torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose poshtëruar, të drejta këto elementare njerëzore të garantuara edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i shkaktuar edhe lëndime trupore”*.
35. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ngritë në Gjykatë, të njëjtat i ka ngritur edhe para gjykatave të rregullta dhe që kanë të bëjnë kryesisht me konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe me mosarsyetim të vendimeve të gjykatave të rregullta, përkatësisht me faktin se sipas tij gjykatat e rregullta nuk i kanë dhënë arsyetimin e mjaftueshëm lidhur me pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
36. Parashtruesi i kërkesës në ndërlidhje me këto pretendime për shkeljen e neneve 23, 27 dhe 29 të Kushtetutës, vetëm ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimin e tij rreth mënyrës se si vendimi i kontestuar, përfshirë edhe

vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e këtyre të fundit.

37. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve 23, 27 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
38. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në esencë ankohet për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e cila garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Panshëm] të Kushtetutës, pasi që thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me pretendimin e tij për mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore, përkatësisht me mungesën e arsytimit specifik lidhur me pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.
39. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e tij, i cili thekson se: *“Si gjykata instanciale e shkallës së parë edhe kjo Gjykatë [Gjykata e Apelit], duke shpërfillur pjesën e Paditësit që bazohet në cenimin e të drejtave të tij kushtetuese, pa u trajtuar fare dhe pa i dhënë adresimin e duhur në fakt i ka mohuar Paditësit zgjidhjen efektive para një organi kombëtar”*. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson para Gjykatës se edhe përkundër pretendimit të tij para gjykatave të rregullta për shkeljen e neneve të Kushtetutës, asnjë instancë gjyqësore nuk është përgjigjur në pretendimin e tij.
40. Fillimisht, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet *“të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsytet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre”* (shih, rastin: *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih, gjithashtu rastin e Gjykatës: KI97/16, parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykimi i 9 janarit 2018, paragrafi 45; shih, rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2018, paragrafi 54).
41. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, edhe kjo Gjykatë në një mori rastesh, ka theksuar se megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesave, gjykatat kanë për obligim të adresojnë pretendimet qendrore për rastet para tyre (shih, *mutatis mutandis*, rastin e sipërcekur të Gjykatës: KI97/16, parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53). Në këtë aspekt, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsytet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih, *mutatis mutandis*, rastin e sipërcekur të Gjykatës: KI97/16, parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

42. Për të vlerësuar saktësisht se a janë trajtuar pretendimet kushtetutese të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Supreme dhe nëse ka pasur “arsyetim të mjaftueshëm” nga Gjykata Supreme, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të rikujtojë arsyetimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 158/2021] të 2 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme, e cila fillimisht e aprovoi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e instancave më të ulëta, duke vlerësuar se këto të fundit drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike si dhe drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale. Për më tepër, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj shton se lidhur me padinë e parashtruesit për kompensim financiar “*nuk është krijuar baza ligjore sepse zyrtari policor nuk ka tejkaluar autorizimet e as nuk ka përdorur forcë joproporcionale përveç asaj të nevojshme për të vënë situatën nën kontroll. Prandaj, kjo gjykatë konsideron se nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet kumulative që lindjen e marrëdhënies juridiko-civile që duhet të përbëjnë këtë raport siç janë: shkaktimi i dëmit, veprimi i kundërligjshëm dhe lidhja shkakësore. Në rastin konkret, nuk është dëshmuar një gjë e tillë sepse me konstatimin e organeve përgjegjëse për procedurë penale dhe përcaktim të përgjegjësië, është gjetur se zyrtari i të paditurës nuk i ka tejkaluar autorizimet, por ka ushtruar punën e vet në përputhje me ligjin*”.
43. Për më tepër, Gjykata rikujton edhe arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit e cila kishte aprovuar në tërësi qëndrimin juridik të instancës së parë, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës për kompensim financiar, me arsyetimin se edhe përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës mund të ketë vlerësuar se ndalimi ka qenë i vrazhdë dhe i panevojshëm, bazuar në paragrafin 1, të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë e Kosovës, në rrethanat e rastit konkret konstaton se zyrtarët policorë duke u bazuar në autorizimet e tyre ligjore kanë vlerësuar se ndalimi dhe dërgimi në Stacionin policor ka qenë i nevojshëm për të marrë deklaratën e parashtruesit të kërkesës.
44. Gjykata konsideron se të gjitha pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, ishin trajtuar dhe kishin marrë një përgjigje nga Gjykata Supreme. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk i referohet asnjë pretendimi konkret për të cilin pretendon të mos ketë marrë një përgjigje nga Gjykata Supreme.
45. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktgjykimi [Rev. nr. 158/2021] i 2 korrikut 2021 i Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, janë të qartë dhe adresojnë esencën e pretendimeve thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, edhe pse në mënyrë shprehimore nuk i referohen neneve përkatëse kushtetuese. Gjykata vlerëson se nuk ka ndonjë argument thelbësor të cilin gjykatat e rregullta e kanë lënë mënjanë si të paarsyetuar, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.
46. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që e ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Themelore.
47. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e gjykatave të rregullta janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se

arsyetimi i dhënë nga Gjykata e Supreme i plotëson të gjitha standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.

48. Më tutje, lidhur me rastet e GJEDNJ-së në të cilat parashtruesi i kërkesës është thirrur në mbështetje të pretendimeve të tij, Gjykata vlerëson se rasti konkret dallon dukshëm nga rrethanat faktike dhe juridike të rasteve në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës.
49. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në Gjykatë, kryesisht ngritin çështje të ligjshmërisë.
50. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih, rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
51. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
52. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
53. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar

një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

54. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Rëmzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

